



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

P.nr.44/2018

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Raima Elezi, si kryetare e trupit gjykues dhe anëtarëve gjyqtarëve Nazim Vllaqo dhe Sabaheta Kurteshi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Valdete Zurnaxhiu, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 329 par 1 të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr. 33/18 datë 29 maj 2018, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Genc Nixha, të akuzuarit A. B.. mbrojtësit të tij av. Sh. B. dhe të dëmtuarit E. S., me datë 20.11.201, morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. B.: me nofkën “X. “ nga i ati F. dhe e ëma A. – e lind. R., i lindur me datën ... në Prizren, ku edhe tani jeton rr. “B.” tani rr. “M.”, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar pa fëmi, punëtor i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal, më herët i dënuar.

ËSHTË FAJTOR

Sepse

Se me datë 22.10.2018 rreth orës 22:30 minuta në Prizren në vendin e quajtur “Sh.” me përdorimin e forcës duke e sulmuar trupin e të dëmtuarit E. S., përvetëson pasurinë e luajtshme

me qëllim që vetit ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ka qenë duke mbledhur kanaqe e sulmon të njëjtin duke e goditur me grushta ku i njëjti pëson lëndime të lehta trupore edhe atë plagë shqyese ndrydhëse në regjionin e pasëm të kokës, gjake mbledhje nënë lëkurore në regjionin përreth dy syve dhe gjakderdhja nga veshi i majtë e pastaj nga dhe nga xhepi i tij merr një telefon të markës “Samsung” si dhe një qese me bukë dhe më pas largohet nga vendi i ngjarjes e më pas telefonin e njëjtë ia shet dëshmitarit B. P.

- Këso dore ka kryer veprën penale të grabitjes nga neni 329 pa 1 të KP -së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 7, 8, 9, 10, 21, 41, 42, 45, 46, 73, 74, 75 par. 1 pika 1.3, 79 par 1 pika 1.3 dhe nenet e përmendur më lartë të KP-së, e

G J Y K O N

-me dënim me gjobë në shumën prej 600 (gjashtëqindë) euro, të cilën dënim është i obliguar të paguaj në dy kiste mujore, duke filluar prej 1 deri 5 të secilit muaj, 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti .

Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj dënimin me gjobë gjykata do të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burg ashtu që për çdo 20 euro të dënimit me gjobë do të caktoj një ditë burg, çka do të thotë 30 ditë burg.

I dëmtuari E. S. për realizimin e kërkesë pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sa i përket ekspertizës mjeko ligjor, sipas llogarisë së gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 100 euro dhe 50 euro në emër të kompensimit për viktimat e krimit, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/L.nr.33/18 të datës 29 maj 2018, kundër të akuzuarit A. B., nga Prizreni, për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni329 par 1 të KP-së.

Pas pranimit të aktakuzës kryetarja e trupit gjykues ka mbajtur shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë ku i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet. Në shqyrtimin kryesor, pas administrimit të provave i akuzuari pas konsultimit të serishëm me mbrojtësin e vet ka vendosur që të pranoj fajësinë duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke u nisur nga fakti se i akuzuari ka pranuar fajësinë dhe duke u bazuar në prova të tjera propozon që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I dëmtuari E. S. është pajtuar me fjalën e prokurorit duke shtuar se parashtron kërkesën pasurore juridike, me atë rast ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokat Sh. B. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i mbrojturi i tij ka pranuar veprën penale ashtu që në atë drejtim nuk ka çka të cekë përveç rrethanave lehtësuese të cilat ekzistojnë në anën e tij edhe atë së pari rrethanë lehtësuese janë pranimi i fajësisë, pendimi i thellë, premtimi se në të ardhmen nuk do të vijë në konflikt me ligjin, gjendjen e tij tejet e rëndë ekonomike, mungesa e pasojave të dëmshme sepse është në pyetje një telefon nga i cili ka përfituar tre euro e gjysmë, andaj duke patur parasysh të gjitha këto rrethana propozon që ndaj tij të ia shqiptohet një dënim sa më të butë me të cilin mund të arrihet qëllimi i dënimit paraparë me ligj.

I akuzuari A. B. ka deklaruar se pendohet shumë për veprimet e veta, është mbajtës i familjes sepse jeton me nënën dhe me vëllain, është në tretman psikiatrikë si pasojë e përdorimit të narkotikut dhe propozon që gjykata të ia shqiptoj një dënim sa më të lehtë.

Në bazë të pranimit të fajësisë dhe në bazë të provave nga shkresat e lëndës është vërtetuar kjo gjendje faktike:

Se i akuzuari A. B. ditën kritike më datë 22.10.2018 rreth orës 22:30 minuta në Prizren në vendin e quajtur “Sh.” me përdorimin e forcës duke e sulmuar trupin e të dëmtuarit E. S., përvetëson pasurinë e luajtshme me qëllim që veti ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ka qenë duke mbledhur kanaqe e sulmon të njëjtin duke e goditur me grushta ku i njëjti pëson lëndime të lehta trupore edhe atë plagë shqyese ndrydhëse në regjionin e pasëm të kokës, gjake mbledhje nënë lëkurore në regjionin përreth dy syve dhe gjakderdhja nga veshi i majtë e pastaj nga xhepi i tij merr një telefon të markës “Samsung” si dhe një qese me bukë dhe më pas largohet nga vendi i ngjarjes e më pas telefonin e njëjtë ia shet dëshmitarit B. P.

Gjykata pas administrimit të provave dhe pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari pasi që ka qenë i bindur se i akuzuari ka kuptuar aktakuzën dhe drejtat e tij, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që e përmban aktakuza dhe provave nga shkresat e lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të çartë ligjore ose gabime faktike ka pranuar pranimin e fajësisë prej të akuzuarit, për veprën penale të grabitjes nga neni 329 par 1 të KP-ës.

Në bazë të gjitha të cekurave më lartë gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kryer me dashje veprën penale, tek e cila vepër penale dashja ka ekzistuar sepse i akuzuari me vetëdije, me përdorimin e forcës ka sulmuar të dëmtuarin me qëllim që të përfiton dobi pasurore të kundërligjshme, prandaj gjykata konsideron se në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KP-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke gjetur si rrethana rënduese shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, shkalla e rrezikut të vlerës së mbrojtur duke pas parasysh se i dëmtuari ka pësuar lëndime trupore, se i akuzuari është recidivist, i dëmtuari parashtron kërkesën pasurore juridike ndërsa si rrethanë lehtësuese janë marrë sjellja korrekte gjatë tërë procedurës, se është relativisht i ri, i gjendjes së dobët ekonomike, pendimi dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, e si rrethanë posaçërisht lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë,

prandaj gjykata, duke marrë parasysh nenin 75 par. 1 nënpar.1.3 të KP-së, e ka dënuar me dënim me gjobë dhe me dënim me burg , si në shqiptimin e këtij aktgjykimi e duke konsideruar se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 të KPP.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në bazë të nenit 463 të KPP.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.44/2018 të dt.20. 11. 2018

Sekretarja juridike
Valdete Zurnaxhiu

Përkthyesi gjyqësor
Asnije Berisha

Kryetari i trupit gjykues
Raima Elezi

UDHËZIM JURIDIKË: Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së aktgjykimit, nëpërmjet kësaj gjykata, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.